



Në bazë të nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 e duke pasur parasysh nevojën e domosdoshme për themelimin e komisionit që del nga dispozita e nenit 8 të Ligjit për Dhenjen në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Palujtëshme të Komunës nr.04/L-144 dhe nenit 2 të Rregullorës QRK nr.23/2013 Për përcaktimin e procedurave të dhenies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës, Kuvendi i komunës së Klinës në seancën e IV-te, të rregullt të punës, të mbajtur më datën 29.05.2015, mori këtë:

V E N D I M

Për

Plotësimin e vendit vakant me anëtar të ri nga subjekti i AAK-se në vend të Agron Bacaj me antarin Lorenc Marleku në komisionin për vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së palujtëshme të komunës (afatshkurtër dhe afatgjatë)

I

Behet plotësimi me anëtarin e ri nga radhët e subjektit politik të AAK-së Agron Bacajt me anëtarin e ri po nga ky subjekt Lorenc Marleku, në Komisionin komunal për vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës në afatshkurtër dhe afatgjatë.

Ky vendim në përberjen e vet ka të gjitha pikat e vendimit të mëparshëm të dt.10.03.2014 më 01.Nr.06-1514, si në vijim.

II

Komisioni përbëhet nga shtatë (7) anëtar, tre (3) anëtar nga Ekzekutivi i Komunës të propozuar nga Kryetari i Komunës, tre (3) anëtar nga Kuvendi i Komunës nga subjektet e ndryshëm të përfaqsuera në Kuvend dhe një (1) anëtar ekspert nga shoqëria civile.

Përberja e komisionit nga pika 1 e këtij vendimi caktohet siç vijon:

1. Pjeter Coli -(KK)
2. Enver Gashi -(KK)
3. Lorenc Marleku-(KK)
4. Esat Raci -(Ekzek.)
5. Enver Marmullaku -(Ekzek.)
6. Baki Gashi - (Ekzek.)
7. Agron Gashi - (Shoq.civile))

III

Anëtarët e Komisionit më shumicë të votave zgjedhin Kryesuesin e Komisionit.

IV

Përgjegjësit e këtij komisioni rregullohen me dispozitat e Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së palujtëshme të komunës nr.04/L-144 dhe Rregulloren QRK nr.23/201 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së palujtëshme të komunës.

V

Mandati i anëtarëve të komisionit përcaktohet më vendim të Kuvendit të Komunës dhe nuk mund të zgjatë me shumë së mandati i rregullt ligjor i anëtarëve të Kuvendit.

VI

Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Klinës, ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas dergimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale.

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01Nr. 02.3608 2014
Më datë 10/106 2014

